



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI RRUGOR SHQIPTAR

TERMA REFERENCE

**Për objektin ;
Studim Projektim i objektit “Rruga Berat – Ballaban”**

TIRANË 2020

I. TË PËRGJITHSHME

Me fondet e buxhetit të shtetit për vitin 2020 dhe në vijim, është planifikuar **Studim Projektim i objektit “Rruga Berat – Ballaban”**.

Rruga Berat – Ballaban kalon nëpër krahinat e Beratit, Tepelenës dhe Përmetit duke lidhur me rruge automobilistike një pjesë të mirë të fshatrave të këtyre rretheve, që ndodhen ndërmjet luginave të lumenjve të Osumit dhe të Molishtit.

Ky segment rrugor është pjesë e aksit nacional rrugor dhe emërtuar me numrin SH 74.

Me hapjen e pikës doganore të Tre Urave me shtetin fqinje, kjo rrugë merr rëndësi të madhe, veçanërisht për këto zona, ku një pjesë e mirë e banorëve punojnë në Greqi. Bujqësia është e zhvilluar sidomos në pemtari dhe kryesisht në kulturat e vreshtarisë, ullinj, qershi etj. Gjithashtu rehabilitimi i kësaj rruge krijon mundësinë e komunikimit më të madh të zonës së Beratit dhe Skraparit me atë të Përmetit, Tepelenës, Gjirokastrës dhe më tej.

Rruga ka një gjatësi prej 55 Km.

Si rezultat i gjatësisë relativisht shumë të madhe, thjesht për lehtësi organizimi dhe thjeshtimi, e gjithë rruga është ndarë në dy pjesë:

Pjesa e Parë: Berat – Buz

Pjesa e Dytë: Buz – Ballaban

Nisur nga trafiku aktual në këtë aks rrugor vërehet se në gjendjen aktuale totalisht të amortizuar të këtij segmenti trafiku realizohet me vështirësi numri i mjeteve ditore është afërsisht më pak se 1000 ATD. Për këtë arsye Konsulentit i propozohet që:

Parametrat e rrugës së re do të jenë:

- Pjesa kaluese 2x3 m të asfaltuara.
- Dy bankina të pa asfaltuara 2x0.75 m.
- Pra gjerësia totale e kurorës është 7.5 m.

Në të gjithë elementët e rrugës Konsulenti do të mbështetet në Rregullat Teknike të Projektimit të vitit 2015, sipas kategorisë “F-(të modifikuar)”.

Gjithsesi Konsulenti do të bëjë matjet e trafikut aktual dhe pritshmërinë për 20 vitet e ardhshme nga ku do të dalë me një propozim .

II. PËRSHKRIMI I GJENDJES EKZISTUESE

Segmenti rrugor Berat – Ballaban fillon në dalje të qytetit të Beratit, pas urës së re të varur për këmbësorë.

Nga km. 0.0 deri rreth km. 1.5 (lokali “Castle Park”) rruga është e asfaltuar dhe zhvillohet në ngjitje në një terren shkëmbor. Pra pika e fillimit do të jetë lokali “Castle Park”. Më pas deri në km 4.0, pjerrësia mesatare e rrugës varion nga 5% deri në 7%. Gjerësi e pjesës kaluese në këtë zonë është rreth 5.0 deri 6.0 m.

Nga këtu, pranë fshatit Drobonik, rruga zhvillohet me anën e dy serpentinave.



Rreth km 5.0 gjerësia e trupit të rrugës zvogëlohet deri në 5.0 – 4.0m. Nga km 5.0 deri rreth km 18.0 rruga zhvillohet në kurriz malor, me ngjitje dhe zbritje të vogla. Rreth Km. 10.0 rruga kalon pranë fshatit Zhitom i vogël dhe rreth Km. 15.0 mbërrin në fshatin Zhitom i madh.



Nga Km. 20.0, rruga vazhdon të zbresë deri sa mbërrin në fshatin Tërpan rreth km. 24, kuota absolute 710 m.



Më tej rruga zhvillohet me zbritje dhe ngjitje deri sa mbërrin ne Qafën e Selenicës rreth km.31, kuotës 820m.

Nga Qafa e Selenices deri në fshatin Rehovë, rreth km. 34, kuota rreth 670m, rruga zhvillohet në zbritje ndërsa më tej ngjitet duke mbërritur ne kryqezimin për në fshatin Gllavë rreth Km.39, rreth kuotës 910 m.

Më tej rruga zhvillohet në zbritje dhe mbërrin në fshatin Buz rreth km. 46, kuota 800 m.

Zhvillimi i mëtejshëm i rrugës realizohet me zbritje dhe ngjitje deri sa mbërrin në Qafën e Kiçokut

Nga Qafa e Kiçokut rruga zhvillohet në zbritje deri sa mbërrin në fshatin pranë urës së Ballabanit.

Në përgjithësi ky aks kalon në terren malor dhe tepër malor. Gjerësia e rrugës ekzistuese vanga 3.5 deri në 5m, me shumë kthesa me rreze të vogël.

I gjithë segmenti rrugor është me kalldrëm dhe me çakëll.



Sinjalistika rrugore pothuajse nuk ekziston.

Përgjatë gjithë aksi rrugor ndodhen ura të vogla, tip hark me qemer guri. Vepra të mëdha arti nuk ka. Pothuajse përgjatë gjithë aksi rrugor ndodhen mure pritës e mbajtës prej guri të cilët në pjesën më të madhe janë shkatërruar.



Vërehen disa zona me qëndrueshmëri të dobët ose me rrëshqitje në km 26+270 deri në km 26+380, në km 33+250 deri në km 33+340 dhe në km 48+800.

Zona e parë në km 26+270 deri në km 26+380, është një rrëshqitje masive me përmasa të mëdha. Në këtë zonë rrëshqet formacioni mbulesor së bashku me pjesën më të përjruar të formacionit rrënjësor me trashësi të trupit rrëshqitës rreth 5-8m.



Zona e dytë në km 33+250 deri në km 33+340, është një zonë e kufizuar me përmasa të vogla në të cilën rrëshqasin formacionet mbulesore.

Zonë e tretë në km 48+800, është zonë me qëndrueshmëri të dobët. Në këtë zonë ujrato sipërfaqësore gërryejnë trupin e rrugës duke gërryer më tej skarpatën e rrugës.

Vlera e shërbimit për Studim Projektimin është 80 677 600 .9 lek me T.V.Sh.

III. OBJEKTIVAT

Objektivi primar i realizimit të këtyre Termave, është që të realizohen të gjitha matjet dhe investigimet e nevojshme për të mbledhur informacionin e saktë për hartimin e projektit në aksin Berat – Ballaban .

Objektivi i dytë është që të bëjë dhe një studim të ndikimit në mjedis duke e shoqëruar dhe me analiza të sakta përsa i përket zënies së tokës, shpronësimeve të mundshme, ndërhyrjes apo ndërthurjes me ekosistemin e zonës, dhe ndikimeve sociale që sjell ndërtimi apo rindërtimi i kësaj rruge.

IV. QËLLIMI I PUNËS

Konsulenti duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë çdo projekt apo studim të mëparshëm që kanë të bëjnë me këtë objekt.

Konsulenti për realizimin e detyrës së tij duhet të studiojë dhe të marrë në konsideratë situatën gjeologjike dhe hidrologjike dhe në mbështetje të tyre të marrë masat e nevojshme inxhinierike. Ai duhet të mbështetet dhe të zbatojë legjislacionin shqiptar për këtë qëllim.

Konsulenti duhet të mbështetet dhe të konsultohet me standartin shqiptar të projektimit të rrugëve (*RrTPRr 2015*) dhe të standarteve tjera të miratuara nga institucione shqiptare.

Konsulenti sipas fazave të projektit të përcaktuara më poshtë do të analizojë dhe të japë të dhëna të hollësishme për shpronësimet e tokës apo objekteve duke dhënë të qarta kufijtë e shpronësimeve dhe llogaritjet e sipërfaqeve sipas pronarëve duke u mbështetur dhe bashkëpunuar me Agjencia Shtetërore e Kadastrës dhe Pushtetin Lokal, gjithashtu konsulenti do të duhet të ketë bashkëpunim të vazhdueshëm me Drejtorite Rajonale të Mjedisit.

Konsulenti duhet të bëjë dhe një analizë ekonomike të fazave të projektit duke u mbështetur në llogaritjet e vizatimeve dhe terrenit dhe duke përdorur çmimet e miratuara me V.K.M.

V. KËRKESAT PËR KONSULENTIN DHE PARAQITJA E DOKUMENTACIONIT.

5.1.1 Projekt-Ideja (projekti konceptual)

Në studimin e këtij objekti Konsulenti duhet të shqyrtojë jo më pak se dy variante por duke mos e kufizuar atë për të studiuar dhe paraqitur dhe variante apo nënvariate tjera që ai do t'i shohë të arsyeshme ti paraqesë.

Gjatë kësaj faze konsulenti duhet që të përfshijë dhe aktivitetet e mëposhtme:

Kryerjen e vëzhgimeve që synojnë në eliminimin e hamendësimeve të bëra gjatë fazave më të herëshme.

Përditësimin e llogaritjeve dhe zëvendësimin e hamendësimeve të bëra më parë.

Përgatitjen e metodologjisë së përgjithshme të ndërtimit.

Përgatitjen e programit të punimeve.

Përgatitjen e vlerësimit të kostos.

Konsultimi me publikun.

Mbi sa më sipër konsulenti gjatë kësaj faze do të përgatisë dhe të paraqesë për miratim studimet që vijojnë.

5.1.2 Studimi Topografik

Për këtë qëllim do të kryhet një rilevim topografik (i vijave dhe kuotave të terrenit) i cili do të hartohet nga konsulenti dhe të jetë i firmosur dhe vulosur.

5.1.3 Studimi Gjeologjik

Ky studim do të paraqesë rezultatet ekzistuese të përfituara prej shpimeve apo mostrave të materialeve të nxjerra para fazës së projekt-idesë duke marrë parasysh dhe studimet e bëra në projekte të mëparshme. Studimi gjeologjik duhet të trajtojë të gjitha çështjet që lidhen me qëndrueshmërinë e dherave veçanërisht me rëndësi të veçantë duhet ti kushtohet studimit të vendeve ku do të parashikohen vepra arti (tombino, tunele, ura etj). Studimi do të shoqërohet dhe me fotografi të cilat së bashku me hartat dhe shpimet e kryera do të shërbejnë për të konfirmuar rezultatet e përfshira në studimin gjeoteknik. Në mënyrë të veçantë do të bëhet vlerësimi i gjendjes ekzistuese të shtresave rrugore. Kjo do realizohet me shpime çdo 100 ml dhe veçanërisht në zonat e dëmtuara. Nëpërmjet analizave të kampioneve do të jepen dhe shkaqet e dëmtimeve të këtyre shtresave rrugore. Analiza duhet të jetë shumë e hollësishme. Studimi do të ketë datë dhe të jetë i konfirmuar nga specialisti gjeoteknik apo grupi i projektimit gjeoteknik.

Të gjitha kampionet dhe analizat laboratorike e marra nga shpimet do të dërgohen dhe ruhen pranë laboratorit të A.Rr.Sh-^{së}.

5.1.4 Studimi Hidrologjik

Duhet të vlerësojë kushtet duke përfshirë dhe studimin e drenazhimit të ujrave sipërfaqësore dhe nëntokësore. Në mënyrë të veçantë do të jepen nivelet e ujrave nëntokësore në zonat me niveletë të ulët për të parë mundësinë e ngritjes së niveletës apo dhe masave të nevojshme inxhinierike për sigurimin e trupit të rrugës. Në përfundim të këtij studimi do të Përgatitet Raporti Hidrologjik i cili do të ketë datë dhe të jetë i firmosur.

5.1.5 Studimi i projektimit të Shtresave Rrugore

Në këtë studim Konsulenti do të mbështetet në planin perspektivë të zhvillimit të zonës duke trajtuar projektimin e shtresave rrugore për çdo seksion rrugor. Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjeçare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigide do të shtrihet për një periudhë 40-vjeçare. Veçanërisht do të bëhet vlerësimi i shtresave ekzistuese në të gjitha zonat e dëmtuara duke bërë një analizë të hollësishme të shkaqeve të këtyre dëmtimeve të shtresave dhe mbi bazën e të dhënave gjeologjike do të jepen rekomandimet e nevojshme për përmirësimin e shtresave sidomos të zonave të dëmtuara, kjo për të ritur kapacitetin mbajtës të këtyre shtresave.

Ky raport do të ketë datë dhe të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

5.1.6 Metodologjia e Ndërtimit

Konsulenti do të përshkruajë për këtë fazë mënyrën se si do të ndërtohet vepra nga pikpamje teknike, llogjistike dhe programore në përputhje me elementet teknike të projektit dhe rekomandimet e VNM. Këtu duhen theksuar rreziqet e veçanta në të cilat do të ndeshet kontraktori dhe mënyrat se si do të përballohen ato prej tij. Ky raport do të ketë datë dhe të firmoset nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

5.1.7 Raporti i Shpronësimeve

Ky raport do të paraqesë një listë të mundshme shpronësimesh për të gjithë variantet që propozohen së bashku dhe me kërkesat dhe procedurat ligjore që duhet të plotësohen në lidhje me projektin.

5.1.8 Kërkesat për leje apo liçensa

Në këtë raport konsulenti do të raportojë për lejet apo kërkesat që klienti duhet të marrë gjatë fazave të projektimit dhe ndërtimit të objektit.

5.1.9 Raporti mbi konsultimin e publikut

Ky raport do të përmbledhë të gjitha propozimet e konsultimit me publikun, me aktorët e tjerë të interesuar, me entet shtetërore si Bordi i Kullimit, KESH, Ndërmarjet Ujësjellës Kanalizime, Telekom, Monumentet e Kulturës, institucionet apo organizmat arkeologjike dhe Drejtorinë Rajonale të Mjedisit etj. Projekt Ideja në këtë fazë do të përmbillet me raportin teknik në të cilin përmbledhet i gjithë procesi i të menduarit që ka shërbyer si bazë e punës për hartimin e Projekt-Idesë. Në të përfshihen planimetritë dhe informacione tjera të rëndësishme siç janë studime të veçanta, foto etj.

5.1.10 Vizatimet

Konsulenti duhet të paraqesë vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia në shkallën 1: 10 000; 1:5 000 ose 1:2 000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme.

Planimetri e rrugës në shkallë 1:1 000; 1:500; 1:200

Profili gjatësor H 1:1 000 V 1: 100 .

Profila tërthor SH 1: 200; 1:100

Profila tërthor tip SH 1:25; 1:50

Harta e rievimit topografik SH 1;1 000; 1:500; 1:200

Harta hidrologjike SH 1:5 000

Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200.

Vizatime të mureve mbajtës apo pritës etj. SH 1: 50: 1:100.

5.1.11 Volumet e Punës dhe Preventivi

Konsulenti do të përgatisë volumet e punës respektive për të gjithë kategoritë e punëve të paraqitura në projekt. Volumet do të llogariten në bazë të vizatimeve të projektit. Çmimet njësi për të gjitha punimet përkatëse do të llogariten duke pasur parasysh çmimet e miratuara me VKM dhe ato që nuk gjenden në manuale të shoqërohen me analiza teknike.

Raporti i Projekt Idese Pasi firmoset dhe vuloset nga specialistët e firmës konsulente paraqitet tek A.Rr.Sh-ja në formë zyrtare për shqyrtim dhe miratim.

Projekt-ideja do të dorëzohet në tre kopje të shkruara dhe në dy kopje në CD në formatin origjinal të punuar.

5.2.1 Kërkesat për Projekt – Zbatimin

Në këtë fazë dhe mbi bazë të variantit përfundimtar të miratuar të projekt idesë nga KT i A.Rr.Sh-së, Konsulenti do të hartojë projektin e zbatimit i cili përfshin Përgatitjen e të gjithë dokumentacionit të nevojshëm.

5.2.2 Raporti Përfundimtar i studimit Topografik

Raporti përfundimtar i Studimit Topografik duhet të përmbajë të gjithë informacionin e rëndësishëm topografik i cili nevojitet gjatë fazës së hartimit të projektit të zbatimit si dhe të asaj të fazës së zbatimit të punimeve. Varianti përfundimtar dhe i miratuar i zgjidhjes së planimetrisë i përcaktuar tashmë dhe i fiksuar në harta dixhitale duhet që për këtë fazë të fiksohet edhe në terren nëpërmjet pikave kryesore të rrjetit koordinativ, të cilat duhet të kenë koordinatat dhe kuotat përkatëse. Këto pika do t'i shërbejnë ndërtuesit për piketimin përfundimtar të aksit në terren, gjithashtu të fiksohen në terren piketa.

Në këtë fazë konsulenti do të paraqesë një raport të saktë të vendodhjes piketave kryesore të vendosura prej tij për zbatimin e punimeve.

Të gjitha kuotat do të jenë absolute dhe të fiksuara në repera fikse betoni. Në çdo rast me fillimin e punimeve nga kontraktori fitues, konsulenti do të jetë prezent për dorëzimin e këtyre piketave.

5.2.3 Raporti përfundimtar i Studimit Gjeoteknik

Konsulenti në Përgatitjen e këtij raporti duhet të rishikojë edhe një herë raportin Gjeoteknik të Përgatitur në variantin e projekt-ideve duke e plotësuar atë me informacione shtesë apo të dala gjatë shqyrtimit të projekt idesë në K.T të A.Rr.Sh- së. Studimi gjeologjik duhet të jetë i saktësuar duke përfshirë të gjithë dukurinë, aksin dhe thellësinë e rrëshqitjes, këndin dhe analizë e saktë gjeomorfologjike të zonave rrëshqitëse. Raporti i Studimit Gjeoteknik duhet të përpilohet për secilën dukuri fiziko-gjeologjike të trajtuar dhe për secilin objekt të veprës duke përfshirë dhe materialet e ndërtimit.

Raporti i Studimit Gjeoteknik do të ketë përmbajtjen si më poshtë:

- Teksti i raportit, parametrat gjeoteknik të projektimit.
- Materiali grafik, harta, planimetritë, prerjet gjologo-inxhinierike dhe në mënyrë të vecantë shpimeve.
- Fotografi ilustrative.
- Konkluzionet dhe rekomandimet e grupit të studimit.

5.2.4 Llogaritjet Përfundimtare të Projektit.

Në këtë fazë Konsulenti do të paraqesë të gjitha llogaritjet e projektit të cilat janë kryer për llogaritjen e shtresave rrugore, të veprave të artit si ato të reja ashtu dhe ato ekzistuese që përdoren në projekt si dhe çdo llogaritje tjetër e cila kryhet në këtë fazë.

Për llogaritjen e trafikut Konsulenti do të mbështetet në standartet shqiptare të miratuara apo të konsultuara me standartet perëndimore apo dhe në studime që Konsulenti ka bërë vetë për këtë qëllim.

Për llogaritjen e shtresave rrugore, Konsulenti do të rishikojë edhe njëherë programin e llogaritjeve që ai ka bërë në fazën e projekt idesë duke i mbështetur ato në provat dhe standarte të miratuara shqiptare në fuqi apo duke i mbështetur në standarte tjera si AASHTO, BS etj por

gjithnjë duke i shoqëruar këto llogaritje me standartin në të cilin ai ka mbështetur llogaritjet e tija.

Ky studim do të shtrihet për një periudhë 20-vjeçare për materialet fleksibël ndërsa për ato rigjide do të shtrihet për një periudhë 40-vjeçare. Ky raport do të ketë datë dhe të konfirmohet nga inxhinieri i projektimit të rrugëve apo grupi i projektimit të rrugëve.

Llogaritjet e veprave të artit do të kenë edhe një herë saktësinë e tyre sipas variantit përfundimtar të miratuar. Këto llogaritje do të mbështeten në studimet përfundimtare gjeoteknike dhe hidraulike duke dhënë zgjidhjet përfundimtare për secilin objekt.

Për zonat e përcaktuara nga raporti gjeologjik, si zona të eroduara, me nivel të lartë ujëshmërie apo tjera duhet të llogarisë dhe të përcaktojë qartë masat inxhinierike me të gjitha detajet e kërkuara si profilin e rrëshqitjes, ujrave nëntokësore, etj.

Për veprat e artit ekzistuese që do përdoren nga konsulenti me modifikime apo zgjerime ai duhet të japë detajet e sakta të ndërtimit rikonstruimit të tyre dhe llogaritjet.

Në këtë fazë konsulenti do të llogarisë dhe përshkruajë edhe masat që do të merren për sigurinë rrugore dhe sinjalistikën.

5.2.5 Përgatitja e metodologjisë përfundimtare të punimeve të ndërtimit

Pas përpunimit të projektit dhe hartimin e projektit përfundimtar të zbatimit Konsulenti duhet të kryejë rishikimin e metodologjisë së ndërtimit. Metodologjia e ndërtimit ndërmjet të tjerave duhet ti referohet dhe çështjeve mjedisore, çështjeve të monumenteve të kulturës apo historike të cilave duhet ti kushtojë vëmendje kontraktori.

Këtu konsulenti do të japë dhe propozimin e tij për vendet e marrjes materialeve që do shërbejnë për lëndë të parë në ndërtimin e objektit cilësinë dhe specifikimet e tyre.

Në këtë fazë gjithashtu, konsulenti do të përshkruajë dhe punimet ndihmëse, nevojat e ndërtimit të rrugëve të shërbimit të spostimeve të ndryshme elektrofoniqe apo tjera që dalin gjatë ndërtimit të veprës.

Në rast se objekti që projektohet është në rrugë ekzistuese e cila do të përdoret gjatë ndërtimit apo i rikonstruksionit të saj, Konsulenti do të përshkruajë në mënyrë të veçantë dhe masat e marra për sigurinë rrugore përfshirë dhe sinjalistikën.

5.2.6 Raporti përfundimtar i shpronësimeve

Konsulenti në këtë fazë do të rishikojë investigimet e kryera në fazën e projekt-idesë duke përshkruar tashmë në mënyrë të qartë dhe të hollësishme listën e pronarëve që shpronësohen sipërfaqet e objekteve apo trojeve të bashkëngjitura me planimetritë e objekteve dhe gen-planet e trojeve, llogaritjet e sipërfaqeve si dhe vlerën e plotë të shpronësimit.

Bashkëngjitur me këto të dhëna do të jenë dhe miratimet e Zyrave të Rregjistrimit të Pasurive të Paluajtëshme apo në mungesë të dokumenteve të pronësisë ato të ALUIZNIT apo çdo miratim tjetër nga Pushteti Lokal. Kjo do të vlejë dhe për pronën shtetërore.

5.2.7 Volumet e punës dhe Preventivi

Bazuar në llogaritjet dhe vizatimet e projektit Konsulenti do të hartojë një listë me të gjitha zërat e punimeve që janë pjesë përbërëse e listës përfundimtare të volumeve (Preventivi).

Preventivi do të shoqërohet me tabelat e volumeve dhe mënyrën e llogaritjes tyre. Çmimet do të jenë ato njësi të miratuara me VKM. Një kopje të listës çmimeve njësi në rast se Konsulenti nuk arrin ta marrë nga fletoret zyrtare mund ta marrë në çdo kohë pranë A.Rr.Sh-së. Zërat e punimeve që nuk janë përfshirë në listën e çmimeve njësi të miratuar Konsulenti do të shoqërojnë me analizën e llogaritjes çmimit.

Preventivi do të shoqërohet me tabelën e llogaritjes së volumeve.

5.2.8 Përgatitja e Raportit Përfundimtar Teknik të Projektit të Zbatimit

Raporti i projektit të zbatimit do të përfshijë të gjithë informacionin e mësipërm si dhe të reflektojë në trajtë të shkruar aresyet mbi të cilat është bazuar hartimi i detajuar i projektit.

Drafti i raportit përfundimtar të projektit të zbatimit do të ketë datë dhe të jetë i firmosur dhe do të paraqitet në formë zyrtare tek A.Rr.Sh-së për shqyrtim dhe miratim.

Gjithashtu konsulenti do të përgatisë të gjithë dokumentacionin e nevojshëm dhe të asistojë klientin në marrjen e lejes së ndërtimit.

5.2.9 Vizatimet

Konsulenti në fazën e projektit të zbatimit në formë grafike duhet të vizatimet e mëposhtme duke organizuar pjesën bazë të dokumentave të kontratës për zbatimin e punimeve.

Horografia në shkallën 1: 10 000; 1:5 000 ose 1:2 000. Në raste që zona e studimit është shumë e madhe duhet të Përgatitet një hartë përmbledhëse në një shkallë të përshtatshme.

Planimetri e rrugës në shkallë 1:1 000; 1:500; 1:200

Profili gjatësor H 1:1 000 V 1: 100 .

Profila tërthor cdo 25 m si dhe në vëndet me karakteristika të vecanta, tombino, ura, kryqëzime etj SH 1: 200; 1:100

Profila tërthor tip.SH 1:25; 1:50

Harta e rilevimit topografik SH 1;1 000; 1:500; 1:200

Harta hidrollogjike e rishikuar ku te tregohen qarte rrjedhjet ujore. SH 1;1 000

Harta gjeologjike SH 1:1 000; 1:500; 1:200.

Vizatime të mureve mbajtës apo pritës etj. SH 1: 50: 1:100.

Vizatimet e veprave te artit, urat, (tre aksiale, mbistruktura, nenstruktura ne nje faqe) SH 1;100

Vizatimet e tombinove SH 1:100 1:50.

Vizatimet e sinjalistikes.

Planimetri te kryqezimeve te propozuara.SH 1; 200

Planimetri te infrastruktures nentokesore dhe mbitokesore me ndryshime te propozuara SH 1;1 000

Planimetritë e shpronësimeve SH 1:1 000 ; 1:500.

Harta te ndryshme te ndjeshmerise mjedisore , te objekteve kulturore dhe arkeologjike ne se ka, per te gjitha variantet SH 1;5 000

Zonat ku do të merren materialet e ndërtimit lëndë e parë përfshirë dhe punimet e përkohëshme vendet e depozitimive etj. SH 1:1 000.

VI. RAPORTI I VLERËSIMIT TË NDIKIMIT NË MJEDIS

Sipas Ligjit Nr. 10440, datë 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, procedura e ndikimit në mjedis përfshin:

- a) Proçesin paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis;
- b) Proçesin e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis.

“**Studim Projektim i objektit “Rruga Berat – Ballaban”**” në bazë të Ligjit 10440, date 07.07.2011 “Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis”, Shtojca I, përfshihet në listen e:

Projekteve që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis, Pika 7 ç) “Ndërtimi i një rruge të re me katër ose më shumë korsi, ose rregullimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese, që ka dy apo më pak korsi, në mënyrë që të bëhet me katër ose më shumë korsi, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe/ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme”.

Hartimi i raportit të VNM – së duhet të bazohet në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 686, datë 29.07.2015 “Për miratimin e rregullave, të përgjegjësive e të afateve për zhvillimin e procedurës së Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis (VNM) dhe procedurës së transferimit të Vendimit e Deklaratës Mjedisore”, në bazë të cilit Konsulenti do të përgatisë:

❖ **PËR FAZËN E PROJEKT – IDESË** konsulenti do të dorëzojë:

1. Relacionin teknik të projektit të propozuar
2. Raportin Paraprak të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis

1. Në Relacionin Teknik të projektit të propozuar, duhet të përfshihen:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administrojnë territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasi të lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zones së projektit;

- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasinë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjislacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Ky relacion duhet të jetë i nënshkruar dhe vulosur nga konsulenti.

2. Raportin paraprak të VNM-së, ku përfshihen:

- a) përshkrimi i mbulesës bimore të sipërfaqes ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar dhe me fotografi;
- b) informacion për praninë e burimeve ujore, në sipërfaqen e kërkuar nga projekti dhe në afërsi të tij;
- c) informacion lidhur me identifikimin e ndikimeve të mundshme, negative, në mjedis, të projektit, përfshirë ndikimet në biodiversitet, ujë, tokë dhe ajër;
- ç) një përshkrim për shkarkimet e mundshme në mjedis, të tilla si: ujëra të ndotura, gaze dhe pluhur, zhurma, vibrime, si dhe për prodhimin e mbetjeve; vendndodhjen e vendepozitimeve të inerteve.
- d) informacion për kohëzgjatjen e mundshme të ndikimeve negative të identifikuar;
- dh) të dhëna për shtrirjen e mundshme hapësinore të ndikimit negativ në mjedis, që nënkupton distancën fizike nga vendndodhja e projektit, dhe vlerat e ndikuara që përfshihen në të;
- e) mundësinë e rehabilitimit të mjedisit të ndikuar dhe mundësinë e kthimit të mjedisit të ndikuar të sipërfaqes në gjendjen e mëparshme, si dhe kostot financiare të përafërta për rehabilitimin;
- ë) masat e mundshme për shmangien dhe zbutjen e ndikimeve negative në mjedis;
- f) ndikimet e mundshme në mjedisin ndërkufitar (nëse projekti ka natyrë të tillë).

Raporti i paraprak i VNM-së të jetë i nënshkruar nga personi fizik/juridik i licencuar.

INFORMIMI, KONSULTIMI DHE DËGJESA PUBLIKE GJATË PROCEDURËS SË THELLUAR TË VNM-SË

Informimi dhe përfshirja e publikut gjatë procedurës së thelluar të VNM-së përfshin këto faza:

- a) Informimin e publikut për projektin e propozuar dhe marrjen e mendimit të tij në fazën e përcaktimit të çështjeve që do të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së, shoqëruar me sqarimet për procedurën në zbatim;
- b) Informimin e publikut për komunikimin që AKM-ja bën me zhvilluesin për çështjet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së;
- c) Informimin, ndërgjegjësimin dhe konsultimin e publikut nga ana e zhvilluesit gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
- ç) Informimin dhe përfshirjen e publikut për organizimin dhe realizimin e dëgjësës publike;
- d) Informimin e publikut dhe marrjen e mendimit të tij nga AKM-ja në fazën e shqyrtimit dhe miratimit të Deklaratës Mjedisore;
- dh) Informimin e publikut gjatë monitorimit të ndikimeve në mjedis të projektit.

Mendimet dhe kërkesat e dhëna nga publiku merren në konsideratë gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së.

❖ **Për fazën e projekt zbatimit konsulenti do të dorëzojë:**

1. Relacionin teknik të projektit
2. Përmbledhjen joteknike të raportit të thelluar të VNM-së;
3. Raportin e thelluar të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis
4. Përmbledhje të konsultimeve me publikun dhe palët e tjera të interesuara, realizuar gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;

Në Relacionin Teknik të projektit, duhet të përfshihen:

- a) qëllimin e projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen në hartë topografike kufijtë e sipërfaqes, të shoqëruar me koordinatat, sipas sistemit koordinativ GAUS KRUGE, fotografi dhe të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti, gjatë fazës së ndërtimit apo funksionimit të veprimtarisë;
- c) informacionin për qendrat e banuara, në zonën ku propozohet të zbatohet projekti, shoqëruar me fotografi dhe të dhëna për distancën e tyre nga vendndodhja e projektit të propozuar, si dhe përcaktimin e njësisë së qeverisjes vendore që administron territorin ku propozohet projekti;
- ç) skicat dhe planimetritë e objekteve dhe strukturave të projektin, si dhe mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve dhe strukturave të projektit;
- d) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese/përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- dh) informacionin për infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacionin për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- e) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar për funksionimin e projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes, pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyra e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacionin për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth/pranë zones së projektit;
- g) informacionin për alternativat e marra në konsideratë, për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) të dhënat për përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, të energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.;
- i) informacionin për lejet, autorizimet dhe licencat e nevojshme për projektin, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjisllacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/ licencimin e projektit;
- j) kopje të lejeve, autorizimeve dhe licencave që disponon zhvilluesi për projektin e propozuar, në përputhje me përcaktimet e bëra në legjisllacionin në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin / autorizimin/licencimin e projektit.

Në Raportin e thelluar të VNM-së, duhet të përfshihen:

Informacion për qëllimin e VNM-së dhe metodikën e zbatuar

- a) Përshkrim të qëllimit dhe objektivave të VNM-së;
- b) Përshkrim të përmbledhur të kuadrit ligjor mjedisor dhe institucional që lidhet me projektin;
- c) Përshkrim të metodikës së zbatuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së:
 - Autorët e hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
 - Metodikat e zbatuara dhe mënyra e sigurimit të informacionit për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së (nëse është e detajuar mund të vihet edhe si shtojcë e raportit);
 - Konsultimet e realizuara gjatë hartimit të raportit të thelluar të VNM-së;
 - Një përshkrim të vështirësive (mangësive teknike ose të njohurive) që zhvilluesi ka hasur gjatë hartimit të informacionit të kërkuar.

2. Përshkrimi i projektit, duke përfshirë:

- a) përshkrimin e qëllimit të projektit të propozuar;
- b) planimetrinë e vendndodhjes së projektit, ku të pasqyrohen, në hartë topografike, sipërfaqja e tokës së kërkuar, kufijtë e sipërfaqes së tokës së kërkuar, të shoqëruar me koordinatat sipas Sistemit Koordinativ GAUS KRUGE, të dhëna për përdorimin ekzistues të sipërfaqes së tokës që do të përdoret përkohësisht apo përherë nga projekti gjatë fazës së ndërtimit apo instalimit të pajisjeve;
- c) skicat dhe planimetritë e objekteve të projektit dhe strukturave të projektit;
- ç) përshkrimin e proceseve ndërtimore dhe teknologjike, përfshirë kapacitetet prodhuese / përpunuese, sasitë e lëndëve të para dhe produktet përfundimtare të projektit;
- d) infrastrukturën e nevojshme për lidhjen me rrjetin elektrik, furnizimin me ujë, shkarkimet e ujërave të ndotura dhe mbetjeve, si dhe informacion për rrugët ekzistuese të aksesit apo nevojën për hapje të rrugëve të reja;
- dh) programin për ndërtimin, kohëzgjatjen e ndërtimit, kohëzgjatjen e planifikuar të funksionimit të projektit, kohën e mundshme të përfundimit të funksionimit të projektit dhe, sipas rastit, edhe fazën e planifikuar të rehabilitimit të sipërfaqes pas mbarimit të funksionimit të projektit;
- e) mënyrat dhe metodat që do të përdoren për ndërtimin e objekteve të projektit;
- ë) lëndët e para që do të përdoren për ndërtimin dhe mënyrën e sigurimit të tyre (materiale ndërtimi, ujë dhe energji);
- f) informacion për lidhjet e mundshme të projektit me projekte të tjera ekzistuese përreth / pranë zones së projektit;
- g) informacion lidhur me alternativat e marra në konsideratë për sa i takon përzgjedhjes së vendndodhjes së projektit dhe teknologjisë që do të përdoret;
- gj) përdorimin e lëndëve të para gjatë funksionimit, përfshirë sasitë e ujit të nevojshëm, energjisë, lëndëve djegëse dhe mënyrën e sigurimit të tyre;
- h) aktivitete të tjera që mund të nevojiten për zbatimin e projektit, si ndërtimi i kampeve apo rezidencave etj.; informacion për lejet dhe licencat e nevojshme për projektin, të kërkuara nga legjislacioni në fuqi, si dhe institucionet kompetente për lejimin/autorizimin/licencimin e projektit.

3. Një përshkrim i analizimit të alternativave të mundshme për zbatimin e projektit ose komponentëve të veçanta të tij (si: aksesit rrugor, administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura, llojet e lëndëve djegëse, vendndodhja e projektit etj.), si dhe sqarimi i arsyeve kryesore për alternativën e propozuar, duke marrë parasysh ndikimet në mjedis të secilës alternativë, si dhe, në rast se ka, mendimet dhe sugjerimet e institucioneve përgjegjëse që mbulojnë fushën e zbatimit të projektit.

4. Një përshkrim të gjendjes dhe vlerave ekzistuese të mjedisit, që mund të ndikohen nga zbatimi i projektit të propozuar, duke përfshirë:

4.1 Përshkrimin e karakteristikave fizike të zonës së projektit:

- Përshkrim të faktorëve klimatikë;
- Përshkrim gjeomorfologjik dhe të sizmitetit të zonës së projektit;
- Përshkrim të gjeologjisë dhe tokës në zonën e projektit;
- Përshkrim të ujërave sipërfaqësore dhe nëntokësore në zonën e projektit.

4.2 Përshkrimin e biodiversitetit në zonën e projektit:

- Përshkrim të habitateve kryesore në zonën e projektit, si dhe harta ilustruese;
- Përshkrim të vegjetacionit në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;
- Përshkrimin e faunës në secilin habitat dhe statusin e ruajtjes kombëtare dhe ndërkombëtare të tyre;
- Përshkrimin e zonave të mbrojtura pranë vendit ku propozohet të zbatohet projekti, përfshirë edhe monumentet natyrore të mbrojtura me ligj.

4.3 Përshkrimin e cilësisë së mjedisit dhe ndikimeve ekzistuese:

- Cilësia e ujërave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Cilësia e ajrit në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Niveli i zhurmave në zonën e studiuar për hartimin e raportit të thelluar të VNM-së;
- Administrimi i mbetjeve në zonën ku propozohet projekti;
- Probleme të tjera (nëse evidentohen), të tilla si: erozioni i tokës, zjarret, ndotje historike etj.;
- Presionet kryesore të mjedisit në zonën e projektit (të tilla si: ndotjet e mjedisit, prerje pyjesh etj.).

4.4 Përshkrim i karakteristikave sociale të zonës ku propozohet projekti:

- Njësia e qeverisjes vendore që administron zonën ku zbatohet projekti;
- Popullsia dhe aktivitetet kryesore ekonomike të zonës;
- Përdorimi i tokës në zonën e projektit;
- Vlerat dhe objektet monumentale dhe arkeologjike në afërsi të zonës së projektit;
- Administrimi i mbetjeve dhe ujërave të ndotura urbane.

5. Një përshkrim të ndikimeve negative të rëndësishme të projektit të propozuar mbi mjedisin ku përfshihen:

5.1 Ndikimet negative në mjedis:

- Ndikimet negative në karakteristikat fizike të zonës së projektit;
- Ndikimet negative në habitate dhe biodiversitetin e zonës së projektit;
- Shkarkimet në mjedis dhe prodhimi i mbetjeve;
- Ndikimet negative shtesë (kumulative) në cilësinë e mjedisit në zonën e projektit dhe burimet natyrore, si mineralet, pyjet, burimet ujore;
- Ndikimet sociale të projektit, të tilla si ndryshimi i përdorimit të tokës dhe shqetësimet që mund të lindin nga ndikimet në mjedis të projektit (si: zhurmat, pluhuri, përdorimi i burimeve natyrore etj.);
- Në varësi të natyrës së projektit, një përshkrim i aksidenteve të mundshme me pasoja në mjedis.

5.2 Karakteristikat e ndikimeve negative në mjedis:

- Metodën e zbatuar për parashikimin e ndikimeve negative në mjedis;
- Shtrirja fizike dhe kohëzgjatja e ndikimeve të identifikuar (shkalla);
- Lloji i ndikimeve të identifikuar (direkte dhe jodirekte);
- Mundësia e zbutjes së ndikimeve dhe argumentimet përkatëse nëse për ndikime të caktuara nuk mund të zbatohen/ndërmerren masa zbutëse;
- Zonat e ndjeshme ndaj ndikimeve të projektit (zona të mbrojtura dhe habitate, qendra të banuara, burime ujore, zona arkeologjike etj.);

6. Ndikimet në mjedisin ndërkufitar të projektit (nëse ka të tilla).

7. Ndikimet pozitive në mjedisin e zonës së projektit.

8. Masat e propozuara për mbrojtjen e mjedisit nga secili ndikim negativ, të identifikuar në paragrafin 5, më sipër.

9. Programin e monitorimit të ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.

10. Planin e menaxhimit dhe monitorimit të mjedisit:

- Rolet dhe përgjegjësitë për zbatimin e secilës masë të propozuar për mbrojtjen e mjedisit, në secilën fazë të projektit;

- Kostot përkatëse të zbatimit të masave të propozuara për mbrojtjen e mjedisit;

- Plani i komunikimit dhe informimit të publikut për ndikimet në mjedis, masat e marra për mbrojtjen e mjedisit dhe monitorimin e ndikimeve në mjedis gjatë zbatimit të projektit.

11. Shtojcat e raportit të thelluar të VNM-së:

- Përmbledhje, në gjuhë joteknike, të raportit të thelluar të VNM-së;

- Kërkesat e veçanta të AKM-së dhe institucioneve të konsultuara,

- Informacion për mënyrën e realizimit të konsultimit gjatë procesit të hartimit të raportit të thelluar të VNM-së dhe metodat e konsultimit, rezultatet përkatëse, kontaktet e personave dhe subjekteve që kanë marrë pjesë në këtë proces, mendimet që janë dhënë dhe arsyetimet se si janë adresuar ose jo në raportin e thelluar të VNM-së, përfshirë edhe kërkesat e mendimet e dhëna në dëgjesën publike;

- Listat e llojeve floristike dhe faunistike në zonën e projektit dhe statusi i ruajtjes/mbrojtjes kombëtare dhe ndërkombëtare;

- Referencat e burimeve të informacionit të përdorur në raportin e thelluar të VNM-së;

Raporti i thelluar i VNM-së dhe Relacioni Teknik të jetë i nënshkruar elektronikisht nga personi fizik/juridik i licencuar. Duhet të dorëzohet certifikata e specialistit/ëve që ka hartuar raportin e thelluar të VNM dhe akti i regjistrimit të personit fizik/juridik, sipas legjislacionit në fuqi.

PËRLLOGARITJA E TARIFËS

Bazuar në Ligjin 10440, datë 07.07.2011 ‘‘ Për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis’’, Shtojca I: **Projekteve që i nënshtrohen procedurës së thelluar të vlerësimit të ndikimit në mjedis**, Pika 7 ç) ‘‘Ndërtimi i një rruge të re me katër ose më shumë korsi, ose rregullimi dhe/ose zgjerimi i një rruge ekzistuese, që ka dy apo me pak korsi, në mënyrë që të bëhet me katër ose më shumë korsi, kur rruga e re ose seksioni i rregulluar dhe/ose i zgjeruar i saj do të jetë 10 kilometra ose më shumë në gjatësi të vazhdueshme’’ si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 354, datë 11.5.2016’’Për miratimin e manualit të tarifave për shërbime në planifikim territori, projektim, mbikëqyrje dhe kolaudim’’, Neni 74 përfshihet në:

- Fazën I ‘‘Aplikimi për VNM paraprake’’,
- Fazën II ‘‘Njoftimi për rastet që duhet të trajtohen në raportin e thelluar të VNM-së’’,
- Fazën III ‘‘Organizim i dëgjesës publike për konsultimin e draft raportit të VNM-së së thelluar’’ për shërbimet e studimeve të ndikimit në mjedis.

‘‘Studim Projektim i objektit ‘‘Rruga Berat – Ballaban’’ i nënshtrohet procedurës së thelluar të VNM-së, në bazë të Nenit 76 të VKM-së Nr. 354 përfshihet në, Grupin e II-të Tarifor.

VII. KOHA DHE DORËZIMI I DOKUMENTAVE

• Projekt Ideja:

Studim Projektimi dhe paraqitja në Këshillin Teknik, jo më shumë se 5 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës. Brenda këtij afati 5 muaj përfshihet edhe oponenta teknike.

• **Drafti i Projekt Zbatimit:**

- Segmenti i Parë: Berat – Buz.
- Segmenti i Dytë: Buz – Ballaban.

Kjo përfshin edhe shqyrtimin në Këshillin Teknik të A.Rr.Sh-së në kohë të diferencuar.

Dorëzimi i plotë i Projekt Zbatimit (duke marrë parasysh të gjitha miratimet) për të gjitha akset rrugore jo më vonë se 10 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.

Dorëzimi i projektit të zbatimit do të bëhet në rrugë zyrtare shoqëruar me fletë inventari. Ato duhet të jenë të firmosura dhe të vulosura në origjinal nga projektuesit. Bashkëngjitur me projektin duhet të sillen dhe miratimet apo opsionet e Pushtetit Lokal ose të institucioneve të sipërpërmendura që kanë bashkëpunuar dhe që janë pjesëmarrës dhe aktorë në këtë projekt.

Afati dhe mënyra e dorëzimit të projektit të zbatimit.

Pas kthimit të draft raportit me vërtetje nga A.Rr.Sh-ja, Konsulenti do të përgatisë dhe dorëzojë në rrugë zyrtare në A.Rr.Sh-ja projektin e plotë të zbatimit së bashku me Raportin Përfundimtar, Specifikimet teknike dhe Preventivin përfundimtar. Drafti të dorëzohet një kopje në formatin e kërkuar.

Projekti do të dorëzohet në formë të shkruar në 4 (kater) kopje të firmosura në origjinal dhe në formatet e kërkuara . Raportet do të dorëzohen në format A4. Projekti i Zbatimit do të dorëzohet në dy kopje elektronike (në disk) në formatin origjinal të punuar ose kompatibël me programet AutoCad. Në mënyrë elektronike do të dorëzohen dhe raportet, preventivi dhe specifikimet teknike. Ato duhet të jenë në formatin origjinal të punuar.

Përveç kësaj Konsulenti do të përgatisë një kopje elektronike me pjesët kryesore të projektit në format PDF së bashku me raportin përfundimtar dhe specifikimet teknike. Kjo kopje elektronike (CD) do të shërbejë për tender.

Konsulenti duhet të dorëzojë dhe dosjen e projektit që do shërbejë për marrjen e lejes zhvillimore dhe të ndërtimit si;

- Mendimi nga Agjencia Kombëtare e Zonave të Mbrojtura përpara mitatimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i Arrsh-së.
- Përcaktimi i venddepozitimit të interteve nga Njësi e Vetëqeverisjes Vendore (NJVV)
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm në bazë të ligjit Nr. 27/2018, "Për Trashëgiminë Kulturore dhe Muzetë" dhe aplikimi pranë Institutit të Monumenteve të Kulturës për Vendimin nga Këshilli Kombëtar i Restaurimeve për objektin që do të ndërtohen përpara mitatimit të projektit zbatimit nga Këshilli Teknik i Arrsh-së.
- Përgatitja e dokumentacionit për heqjen nga fondi pyjor në mbështetje të VKM nr.1353, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave për paraqitjen e kërkesës, mbajtjen dhe plotësimin e dokumentacionit teknik, si dhe të kritereve e të procedurave të zvogëlimit të sipërfaqes e të vëllimit të fondit pyjor", i ndryshuar, si dhe të VKM nr.1374, datë 10.10.2008 "Për përcaktimin e rregullave dhe të procedurave që ndiqen për heqjen, shtimin dhe ndryshimin e destinacionit të fondit kullosor",

- Përgatitja e vëzhgimi arkeologjik për Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik bazuar në ligjin Nr.9048, date 07.04.2003 “PËR TRASHËGIMINË KULTURORE” i ndryshuar .
- Përgatitja e dokumentacionit të nevojshëm për kërkesën “Për përdorim të burimeve ujore për veprimtari ndërtimore në brigje”, Bazuar në Ligjin Nr. 111/2012 datë 15.11.2012 “Për menaxhimin e integruar të burimeve ujore” si dhe Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.416, datë 13.5.2015 “Për miratimin e kushteve të posaçme, dokumenteve shoqëruese, afatin e vlefshmërisë, formularëve të aplikimit për autorizim dhe leje, procedurave të shqyrtimit dhe vendimmarrjes, si dhe formateve të autorizimit dhe lejes për përdorim të burimeve ujore”.
- Konsulenti duhet të përgatisë dokumentacionin e nevojshëm për aplikimin e Lejes së Infrastrukturës nga Arrsh-së, bazuar në ligjin Nr. 107/2014 datë 31.07.2014 ‘‘Për Planifikimin dhe Zhvillimin e Territorit’’ i ndryshuar dhe në Vendimin Nr. 408, datë 13.05.2015.

Grupi i Punës.